



**NATIONAL  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE**  
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

# MAQEDONI

**Punon për përforcimin dhe  
zgjerimin e demokracisë në botë**

Maj 2003 - Gusht 2003

Viti 1, Numri 2

## Duke biseduar për politikë



Qytetarët e Maqedonisë, të pyetur për përfaqësuesit e tyre të zgjedhur, njëzëri përgjigjen se ata nuk meren me hallet e njerëzve që i përfaqësojnë. Ata thonë se në periudhën jozgjedhore politikanët shumë rrallë shihen në mesin e njerëzve, përveç në medime. Shumica e njerëzve nuk kanë ide se cili politikan i përfaqëson interesat e tyre e as se çfarë bëjnë ata gjatë periudhës jozgjedhore.

Megjithatë, kjo dukuri gjatë muajve të kaluar ka filluar të ndryshojë. Ky numër i informatorit të *NDI Maqedoni* paraqet forma të reja me të cilat deputetët i tregojnë qytetarëve se dëshirojnë të kontaktojnë me ata. Reagimet janë inkurajuese. Qytetarët radhiten në zyrat e poshapura për kontakt me qytetarë, paraqiten si dëshmitarë për të prezantuar propozimet e tyre në debatet publike dhe marrin pjesë në mbledhje të organizuara në qytete të ndryshme ku diskutojnë për çështje të rëndësishme.

Zyrtarët e zgjedhur gjithashtu përballohen me sfidën për t'i treguar qytetarëve se në zemrat e tyre ata kanë interesin publik, dhe jo atë politik apo personal. Edhe katër deputetë tjerë të Parlamentit hapën zyrë për kontakt me qytetarë në Gostivar dhe Dibër. Së bashku me katër deputetë tjerë të cilët kanë hapur zyrë të tillë në Kisella Vodë, ata janë duke shfrytëzuar kompetencat e tyre si deputetë për të marrë përgjigje prej qeverisë dhe rezultate për zgjedhësit e tyre. Suksesi i këtyre zyrave, në fakt, solli deri te mbështetja e propozimit për legjislacion nga të gjitha partitë në parlament gjë që do të ndihmonte çdo deputet të hapë zyrë në njësinë e tij zgjedhore.

Në frymë të njëjtë udhëheqësia e BDI-së mbajti një seancë para medimeve për të prezantuar punën e tyre në qeveri, përfshirë arritjet dhe sfidat që duhet të zgjidhen. Mbledhje të shumta pasuan nëpër komuna ku qytetarët mund të gjykonin vetë për të arriturat e BDI-së, edhe atë në

## Vizitë studiu Parlamentit të Hungarisë



Poshtë, nga e majta në të djathtë: Jani Makraduli, Aleksandar Novakoski, Sheila Fruman, Tome Trombev

Në mes, nga e majta në të djathtë: Hisni Shaqiri, Nevzat Bejta, Adnan Jashari, Eleonora Petrova-Mitevaska, Bllagorodna Mingova-Krepieva, Sonja Lepitkova, Roza Topuzova-Karevska

Lartë, nga e majta në të djathtë: Elvis Zutic, Zoran Shapuriç, Zoran Krstevski

*Shikoni faqen 2*

prag të zgjedhjeve.

Në ndërkohë, Asociacioni Qytetar MOST ka promovuar Parlamentin Mobil, i cili sjell së bashku OJQ-të dhe deputetët për t'i diskutuar çështjet që e brengosin komunitetin. Një takim i tillë rezultoi në bashkimin e forcave të tre deputetëve nga parti të ndryshme politike për të adresuar shqetësimet e përbashkëta të qytetarëve një qasje shumë-partiake rrallë herë e parë.

Si një hap tjetër fillestar, parlamenti për herë të parë mbajti debatë publike ku dëshmitarët ishin ftuar për të përcjellur përvojat e tyre për përpilimin e një Kodi të Sjelljes për deputetë. Siç komentoi më vonë një deputet me përvojë "Kjo ishte hera e parë që u ndjeva i rëndësishëm si deputet".

Drejtor



## Vizitë njërit prej parlamenteve më të bukura të Evropës



Anëtarët e delegacionit të fascinuar nga pamja e Danubit

**H**ungaria ofron një shembull interesant të një tranzicioni të suksesshëm të kohëve të fundit prej sistemit një partiak në demokraci shumë partiake. Qysh prej fillimit të viteve të '90-ta Kuvendi kombëtar hungarez është shndëruar në institucion qendror në qeverisjen e vendit. Parlamenti hungarez ka evoluar prej një institucioni me anëtarë që nuk kanë pasur përvojë politike dhe model të funksionimit demokratik, në një institucion me politikanë profesional dhe me përvojë. Fillimisht me mungesë të personelit punues, teknikës dhe mjeteve, Kuvendi kombëtar tash funksionon me njerëz dhe mjete të mjaftueshme për të mundësuar deputetët të përmbushin rolin e tyre si ligjvënës dhe përfaqësues të popullit. Parlamenti luan rol të rëndësishëm në nxjerrjen e ligjeve, ka të zhvilluar një sistem efektiv të komisioneve dhe vazhdimisht zbaton kontrollë mbi qeverinë.



Deputetët Adnan Jashari, Bllagorodna Mingova-Krepieva dhe Nevzat Bejta punojnë në plan veprimin e tyre për Parlamentin e Maqedonisë gjatë udhëtimit studiuës

## Hapja e perspektivave të reja

Shkruan: mr. Jani Makraduli  
Kordinator i grupit parlamentar të SDSM-së

Në suaza të bashkëpunimit të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë dhe NDI-së, të ndihmuar nga programi i World Learning prej 21-26 maj 2003 u organizua një udhëtim studiuës në Parlamentin e Republikës së Hungarisë.

Delegacioni shumëpartiak ishte i përbërë nga deputetët: Eleonora Petrova-Mitevaska, Sonja Lepitkova, Roza Topuzova-Karevska, Bllagorodna Mingova-Krepieva, Hisni Shaqiri, Adnan Jashari, Nevzat Bejta, Zoran Krstevski, Zoran Shapuriç, Tome Trombev, Jani Makraduli dhe Sekretari i përgjithshëm i Parlamentit, Aleksandar Novakoski. Dëshiroj të përmend se deputetët e ftuar nga radhët e VMRO-DPMNE-së nuk erdhën në këtë udhëtimin studiuës për shkak të aktiviteteve partiake, derisa deputetët e PDSH-së nuk iu bashkangjitën delegacionit për shkak të abstinimit të tyre nga puna e parlamentit.

Programi i organizuar në mënyrë të shkëlqyer ofroi aktivitete të ndryshme: takime me përfaqësues të udhëheqësisë së parlamentit, zyrtarët politik dhe strukturat parlamentare dhe gjithashtu takime me parti politike, kryetarë të komisioneve të caktuara, si dhe takime individuale me deputetë.

Gjatë qëndrimit, delegacioni i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë kishte rastin jo vetëm për t'u njohuar me metodat e punës së parlamentit hungarez, por gjithashtu edhe të shkëmbejë përvoja dhe mendime për çështje të ndryshme. Si rezultat i këtyre takimeve, delegacioni ishte unanimit në përcaktimin e tyre për të përforcuar rolin e komisioneve në parlament me theks të veçantë në detyrat që duhet të përfundohen gjatë procesit të afrimit drejt Evropës, marrë nga përvoja e disa trupave punues dhe komisioneve.

Takimet individuale me deputetë kishin rëndësi të veçantë për shkak se ne kishim rast të njohohemi me punën e tyre në teren dhe takimet e tyre të rregullta që i kishin me zgjedhësit e tyre në zyrat për kontakt me qytetarë. Plani i vizitës poashtu na mundësoi të vizitojmë një zyrë të tillë dhe kjo vizitë hapi perspektiva të reja për delegacionin tonë.

Gjatë vizitës studiuëse delegacioni kishte mundësi të ndjekë një takim koordinativ të partisë më të madhe në parlament si dhe një seancë plenare në të cilën u miratua rendi i ditës për javën punuese dhe u parashtruan pyetje nga deputetët.

Delegacioni dëshiron t'i shpreh faleminderime të veçanta z. Peter Hack, ish-deputetit të parlamentit hungarez dhe kryetarit të Komisionit për çështje kushtetuese, legjislativ dhe juridike, i cili duke u bazuar në përvojën e tij me zemërgjërësi ofroi shpjegime dhe këshilla.





## BDI hap dy zyra për kontakt me qytetarë



Deputetët Agron Buxhaku dhe Talat Xhaferi gjatë hapjes së zyrës së tyre në Dibër



Deputetët Nevzat Bejta dhe Adnan Jashari gjatë hapjes së zyrës së tyre në Gostivar

“Në pamundësi për të marrë përgjigje nga institucionet përkatëse, zyra e deputetëve na mundësoi që problemi ynë të arrijë deri në parlament dhe të kërkohet zgjidhje për të”.

*Nizam Tairi, Mersel Tairi, Fehim Tairi dhe Esad Ademi - qytetarë të Gostivarit*



## PARLAMENTI MOBIL

### Parlamenti mobil i MOST-it bashkon deputetët dhe qytetarët



Deputetët Zharko Karaxhoski, Lupço Meshkov dhe Bllagoja Geshoski në Prilep gjatë parlamentit mobil rreth të ardhmes së prodhimit të duhanit.



Deputetët Bllagoja Gollomeov, Sillobodan Danevski, koordinatori i MOST-it Sllavica Biljarska, moderatori Dragan Antonovski dhe deputeti Risto Pejoski në parlamentin mobil në Veles rreth ligjit për financimin e vetëqeverisjes lokale.



## Parlamenti mban

### debatin e parë publik

**M**ë 23 qershor një panel shumë partiak i deputetëve mbajtën debatë publike për etikën legislative dhe Kodin e Sjelljes për deputetë. Debatet publike u organizuan me bashkëpunimin e Komisionit parlamentar për sistem politik dhe marrëdhënie ndëretnike dhe NDI-së. Këto ishin debatet e para publike dhe zyrtare që ndonjëherë janë mbajtur në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë. Sipas të gjitha të dhënave, këto debate ishin sukses shumë i madh.

### Rekomandime të dëshmitarëve për Kodin e Sjelljes së deputetëve

- Publikim financiar i pronës së deputetëve dhe familjes së tyre
- Pa nepotizëm
- Mos abuzimi i shërbimeve dhe privilegjeve nga deputetët për interesa personale apo familjare
- Deputetët nuk duhet të prishin kredibilitetin e parlamentit, deputetëve tjerë apo qytetarëve me veprimet e tyre
- Çdo grup parlamentar dhe çdo deputet individualisht duhet të ndihmojë krijimin e marrëdhënieve më të mira në mes partive.
- Deputetët dhe grupet parlamentare duhet në mënyrë më efektive të përdorin kohën e caktuar për diskutime në parlament
- Deputetët duhet të orvaten të përfaqësojnë interesin e përgjithshëm të opinionit dhe në rast konflikti të interesave ai/ajo duhet publikisht ta prezantojë atë
- Deputetët duhet të kryejnë detyrën e tyre me profesionalizëm (ndjekje të rregullt të seanceve, pjesëmarrje aktive në debate publike, komunikim me qytetarë)

Pesëmbëdhjetë dëshmitarë u paraqitën, përfshirë edhe deputetë, OJQ-të dhe ekspertë. Duke u bazuar në paraqitjet e tyre duket qartë se plotësisht mbështetet Kodi i Sjelljes për deputetë që do të kishte vendosur normat etike për të udhëzuar deputetët në punën e tyre të përditshme. Shumica e dëshmitarëve besojnë se Kodi i sjelljes do të risë vetëdijen e deputetëve për përgjegjësitë e tyre, do të përforcojë integritetin e deputetëve dhe parlamentit si institucion dhe do të përforcojë besimin e qytetarëve në deputetë.

Disa dëshmitarë theksuan nevojën për të themeluar një organ profesional që do të ishte neutral dhe do të ishte përgjegjës për implementimin e Kodit të Sjelljes për deputetë.

## Debatet publike të mirëseardhura nga deputetët si mjet inovativ

Shkruan: **mr. Zoran Shapuzić**  
Kryetar i Komisionit për sistem politik dhe marrëdhënie ndëretnike



Sa i përket Kodit të Sjelljes së deputetëve dhe etikës legislative, unë personalisht mendoj se debati i fundit publik që u mbajt në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë i organizuar nga Komisioni për sistem politik dhe marrëdhënie ndëretnike dhe NDI, demonstroi interesin e lartë të deputetëve po edhe të opinionit më të gjërë. Përdorimi i debatit publik për të ngritur këtë çështje, që do të thotë deputeti dëgjon deklaratat për një çështje të caktuar, është një risi e rëndësishme në punën e parlamentit. Vetë debati publik shpalosi vizione të ndryshme rreth temës. Në çdo rast, deputetët shprehën vullnet të qartë që kjo çështje të standardizohet: në formë të një Kodi nëpërmjet inkorporimit të tyre në Rregullore apo nëpërmjet miratimit të një akti të ri ligjor nga ana e parlamentit. Kjo do të kishte rregulluar sjelljen e deputetëve, si dhe të drejtat dhe obligimet e tyre që do të ishin në interes të deputetëve dhe opinionit. Kjo do të duhej të bëhet në përputhje me normat tjera ligjore si për shembull legjislacioni për anti-korrupsion, ligji që ka të bëjë me konflikt të interesave, etj. Kjo megjithatë nuk e përjashton nevojën për të kaluar një ligj të veçantë për deputetë ku do të ishin rregulluar të drejtat e tyre, obligimet, kushtet e punës dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me punën e tyre në parlament. Gjithë kjo e thekson rëndësinë e Kodit të Sjelljes për deputetë dhe etikë legislative dhe tregon nevojën për të mbajtur më shumë debate publike në tema specifike në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë.

### Sanksionet e rekomanduara nga dëshmitarët në debatin publik për thyerjen e Kodit të Sjelljes së deputetëve

- Qortim publik
- Dënim me para
- Suspendim i mandatit
- Ulje të pozitës
- Paralajmërim
- Përjashtim prej parlamentit



# Përforcimi i bashkëpunimit në mes parlamentit dhe OJQ-ve

**I**nstituti Nacional Demokratik për Çështje ndërkombëtare dhe Asociacioni qytetar MOST më 7 prill në Shkup së bashku organizuan një konferencë për përforcimin e bashkëpunimit në mes parlamentit dhe OJQ-ve në Maqedoni.

Nëpërmjet të një sërë panelesh dhe punëtorish, deputetët dhe përfaqësuesit e OJQ-ve kishin një rast unik të mësojnë dhe diskutojnë rreth mënyrave të rritjes së bashkëpunimit.

## Përfundime nga konferenca

- ☑ Parlamenti duhet të hapë zyrë për qytetarë
- ☑ Internet faqja e parlamentit duhet të freskohet me informata nga rendi i ditës për seanca plenare dhe të komisioneve, vendime të miratuara, transkripte dhe me informata tjera relevante.
- ☑ Parlamenti duhet të organizojë diskutime publike ku të gjitha OJQ-të e interesuara dhe qytetarët do të mund të marrin pjesë
- ☑ Deputetët duhet të hapin zyra në njësitë e tyre zgjedhore në mënyrë që qytetarët të mund t'i kontaktojnë me pyetje dhe kështu të kontribuojnë në procesin e marrjes së vendimeve.
- ☑ Duhet të ndryshohet Rregullorja e Punës së Parlamentit për të mundësuar pjesëmarrjen e opinionit.



Radha e parë nga e majta në të djathtë: Mitko Bashov nga Forumi Evropian nga Gjevgjelija, deputetët Marija Kujzekliska, Sllavica Grkovska, Tome Trombev dhe Eftim Manev



**N**ë përputhje me kërkesat kushtetuese dhe Rregulloren e Punës, Parlamenti i Maqedonisë ka filluar të përkthejë ligjet e miratuara në gjuhën shqipe dhe të ofrojë përkthim simultan prej gjuhës shqipe në atë maqedonase gjatë mbledhjeve të komisioneve dhe seancave plenare.

Nëpërmjet programit të saj parlamentar për përdorimin e gjuhëve, NDI ka pajisur sallat e komisioneve me mjete për përkthim simultan, ka blerë fjalorët më të nevojshëm për parlamentin, dhe më së fundi organizoi një kurs të shpejtuar në Katedrën për Përkthim dhe Interpretim pranë Univerzitetit të Shkupit për përkthyes-interpretuesit e rinj të punësuar në parlament.

Për gjashtë javë të tëra në qershor dhe korrik, pas orarit të punës përkthyesit e parlamentit duhej të mbledhin tërë

energjinë e mbetur dhe ballafaqohen me nxehtësinë e madhe të kësaj vere për të mësuar disa nga aftësitë speciale dhe teknikat që nevojiten për të qenë interpretues profesional. Në fund të kursit, përkthyesit vlerësuan se kursi ka qenë shumë i dobishëm për ta, dhe nëse asgjë tjetër, ka mundur të zgjasë më tepër!

## Përkthyesit e parlamentit mësojnë teknika të reja





Shkruan: David Dougherty  
Drejtor i programit për parti politike

## Degë të forta Parti të forta

Në botën konkurruese të politikës, shpesh duket se është gati e pamundur për partitë të pajtohen në diçka. Gjatë zhvillimit të programit që do të ishte joshëse për të gjithë partitë më të mëdha në Maqedoni, ne në NDI duhej të pyesim një pyetje shumë të thjeshtë: çfarë është ajo prej të cilës çdo parti do të përfitonte, pa marrë parasysh nëse është parti e madhe ose e vogël, e vjetër ose e re, shqiptare apo maqedonase?

Përgjigjja ishte se partitë në Maqedoni kanë nevoja të njëjta si partitë në çdo demokraci tjetër: aktivistë të trajnuar mirë në nivel lokal, dhe degë lokale që lidhin opinionin me partinë dhe me vetë qeverinë. Këto nevoja janë të intensifikuara nga vetë fakti se viti 2004 sjell zgjedhjet vendore, që do të thotë se partitë duhet pasur strukturë efektive në një sërë vendesh dhe në të njëjtën kohë, varësisht nga parashikimet e tyre për mundësi elektorale. Prandaj ekziston programi i NDI-së për parti politike për vitin 2003-2004... Udhëheqës të rinj & zhvillimi i degëve lokale.

Qëllimi i këtij programi është që të sigurojë trajnime dhe konsultime për aktivistët e degëve lokale si pjesë e përpjekjeve për të kultivuar udhëheqës të mirë lokal dhe degë të fortë komponentë fundamentale për një parti moderne dhe efektive. NDI do të punojë drejtpërdrejt me udhëheqësinë partiake dhe përfaqësuesit e degëve lokale për t'i përmirësuar aftësitë teknike të aktivistëve të partisë në sferat kyçe dhe për të ndërtuar kuptim për përfitimet e vetë partive nga degët mirë të organizuara.

## Aktivistët e BDI-së vërshuan komunitetet pas seminarit të NDI-së

Më shumë se 60 aktivistë morën pjesë në seminarin e përbashkët të BDI-së me NDI-në në Mavrovë në muajin qershor që inkorporoi prezantim vizuel të arritjeve të BDI-së në qeveri, prezantime rreth asaj se si të komunikojnë me qytetarët dhe të ndërtojnë mbështetje, dhe punë në grupe për të zhvilluar plan veprimi në nivel lokal.

Qershori i dha frytet e kësaj pune kur më shumë se 50 takime u organizuan nga degët lokale të BDI-së në qytete dhe fshatra prej Kumanove deri në Kërçovë, me publik prej 10-400 njerëz për të dëgjuar arritjet e BDI-së dhe sfidat me të cilat kjo parti ballafaqohet. Broshura që përmbledh temat kryesore të prezantimit të BDI-së bashkë me informatat se si mund të kontaktohen deputetët dhe zyrtarët tjerë ishin të distribuara gjatë takimeve.



Më shumë se 60 aktivistë marrin pjesë në seminarin për përforcimin e degëve lokale në Mavrovë

“Dëgjuam shumë rreth disa temave që paraqesin risi në politikë, implementimi i të cilave do të na dallojë nga praktikat e partive tjera politike.”

*Xheladin Shatku  
Pjesëmarrës në seminar*

“Mendoj se transparenca dhe komunikimi i sinqertë me qytetarët do të na bëjë më të afërt me ta dhe do të mundësojë arritje të reja.”

*Fatmir Dehari  
Pjesëmarrës në seminar*

# Udhëheqësit e rinj të Partisë Liberale



Aktivistët e partisë liberale gjatë seminarit të NDI-së në Shkup

**D**uke luftuar me imazhin e tyre të qenurit grup parlamentar më i vogël në parlament, aktivistët e partisë liberale ishin të parët që e nisën programin e NDI-së për udhëheqës të rinj & zhvillim të degëve lokale. Më 18 korrik, njëzetë aktivistë partiak morën pjesë në seancën e parë njëditëshe të programit njëvjeçar për të hulumtuar mënyrat se si të aftësohen dhe të mësojnë teknika të reja për përf forcimin e degëve të tyre lokale.

Çdo pjesëmarrës do të bëjë vlerësim të degës për të pasur një pasqyre të qartë për fuqinë, dobësitë, nevojat dhe potencialin e saj. Ata do të fokusohen në tre sfera kryesore të përmbajtura në programin e NDI-së: komunikimet, praktikat e menaxhimit dhe procedurat e brendshme. Rezultatet do ta formojnë bazën e seancave të ardhshme punuese me NDI-në.

Seanca të ngjashme janë të planifikuara me LSDM, VMRO-DPMNE dhe PLD në vjeshtë.

“Kishte shumë ide se si të organizohen organet lokale që mund të përdoren në praktikë...”

*Dejan Talimdzioski  
Pjesëmarrës në seminar*



**Nikolla Kjurkciev**  
SDSM

“Aktivitetet e LSDM-së janë paraqitur në dokumentin e miratuar nga kongresi ynë i katërt. Angazhimi politik gjithashtu nënkupton “furi” të ideve dhe iniciativave të reja. Ne do të përforcijmë degët tona lokale që më mirë t’i implementojmë përgjegjësitë nga mandati ynë në qeveri.”



**Gëzim Ostreni**  
BDI

“Prioritet e BDI-së gjatë vitit të ardhshëm do të jenë puna në përforcimin e kapacitetit organizativ me që kjo përpjekje do të mundësojë që partia jonë të funksionojë më mirë dhe të ballafaqohet me sfidat. Kjo është në pajtim me përpjekjet e partisë për të imponuar një mentalitet të ri politik në vend.”



**Roza Topuzova Karevska**  
PLD

“PLD do të përqëndrohet në përforcimin e aspektit organizativ të strukturës partiake dhe do të përgatitet për zgjedhjet në degët lokale. Ne do të vazhdojmë të angazhohemi për realizimin e programit (tonë parazgjedhor.”



**Den Doncev**  
VMRO-DPMNE

“Prioritetet tona janë selektimi i degëve lokale dhe implementimi i strukturës së re organizative. Ne jemi partia e parë në vend që implementon praktika moderne gjatë zgjedhjes së kryetarëve të degëve lokale. Ne do të bëjmë të njëjtën me strukturën tonë të re gjë që do të na përgatisë për t’i fituar zgjedhjet e ardhshme.”



**Zoran Dimov**  
LP

“Prioriteti i partisë liberale është mbajtja e konventave vjetore në nivel të degës si dhe përgatitja për Kogresin e partisë. Ne jemi duke ndërtuar strategji për transferimin e aktiviteteve të caktuara në nivel lokal dhe në format specifike të organizimit të anëtarësisë së partisë.”



**Ruzhdi Matoshi**  
DPA

“PDSH-ja do të punojë drejt implementimit të plotë të Marrëveshjes Kornizë ashtu siç janë pajtuar partitë në Ohër. Ne do të kundërshtojmë çdo tendencë për të degeneruar atë.”

KËNDI I SEKRETARËVE TË PËRSGJITHSHËM

**Në numrin vijues:**

# Gjeneratë e re praktikantësh në Parlament



“Kjo është një mënyrë e shkëlqyeshme për të ndihmuar punën e deputetëve dhe në të njëjtën kohë për të trajnuar të rinjtë. Kur e them këtë duhet të uroj NDI-në që bëri zgjedhjen e këtyre të rinjëve është e qartë se puna është kryer duke u bazuar në metodologji të mirë dhe kritere objektive.”

*Liljana Popovska  
Nënkryetare e parlamentit*

## INSTITUTI NACIONAL DEMOKRATIK


Kryesues  
Madeleine K. Albright  
Kryetar  
Kenneth D. Wollack  
Drejtor regional  
Robert Benjamin

### NDI Maqedoni:

Sheila Fruman - Drejtor  
Elvis Zutic - Drejtor i programi parlamentar  
Aleksandra Cvetkovska - Programi parlamentar  
Emil Atanasovski - Programi parlamentar  
David Dougherty - Drejtor i programit për parti politike  
Lidija S. Zafirovska - Programi për parti politike  
Flora Sulejmani - Programi për parti politike  
Herman De Fraye - Drejtor i programit për përdorimin e gjuhëve  
Tatjana Bundaleska - Programi për përdorimin e gjuhëve  
Ismail Ebipi - Programi për përdorimin e gjuhëve  
Klimentina Blazheska - Sekretar administrativ i zyrës së dytë  
Ardit Memeti - Menaxher administrativ  
Gëzim Jashari - Hulumtim dhe komunikim  
Daniela Dodevska - Menaxher i zyrës kryesore



Për informata më të hollësishme për programet dhe publikimet e NDI-së, Ju lutemi vizitoni internet faqen tonë [www.ndi.org](http://www.ndi.org), ose na kontaktoni në [ndi@ndi.org.mk](mailto:ndi@ndi.org.mk)



### Zyra kryesore

Dame Gruev 7  
1000 Skopje, Macedonia  
Tel.: +389 (02) 31 31 177  
Fax.: +389 (02) 31 28 333

### Zyra e programit për përdorimin e gjuhëve

Dame Gruev 1/2/8  
1000 Skopje, Macedonia  
Tel.: +389 (02) 32 96 578  
Fax.: +389 (02) 31 20 101

*Instituti Nacional Demokratik për çështje ndërkombëtare është organizatë joprofitabile me qendër në Uashington. NDI në Maqedoni është i mbështetur nga USAID. Programi i NDI-së për përdorimin e gjuhëve është i mbështetur nga qeveria e Belgjikës.*